

URBANIZATION AND SOCIAL PROBLEMS LINKED WITH: NEW CHALLENGES FOR THE CITY OF SHKODRA

URBANIZIMI DHE PROBLEMET SOCIALE TË LIDHURA ME TË: SFIDA TË REJA PËR QYTETIN E SHKODRËS

BRESENA KOPLIKU, NEVILA DIBRA

Universiteti I Shkodrës “Luigj Gurakuqi”, Fakulteti I Shkencave Shoqërore, Departamenti i Gjeografisë
bkopliku@unishk.edu.al

AKTET VI, 3: 313-317, 2013

PERMBLEDHJE

Urbanizimi i shpejtë, si pasojë e lëvizjeve të brendshme të popullsisë konsiderohet si një ndër veçoritë kryesore të shoqërisë shqiptare të pas 1990. Tendencën e urbanizimit është e lidhur më tepër me shpopullimin e zonave rurale dhe malore pra me migracionet, sesa me shtesën natyrore. Vitet e fundit u populluan toka që ishin të destinuar për zhvillimin e bujqësisë, të industrisë, brigjet e lumenjve, liqenit ose zonat e mbrojtura. Këto zona u zhvilluan jashtë kuadrit ligjor dhe në kundërshtim me planet e zhvillimit dhe shtrirjes së qytetit. Urbanizimi është i rëndësishëm për rritjen e ekonomisë kombëtare, por nga ana tjetër, kur ndodh në mënyrë kaotike shoqërohet edhe me probleme sociale. Disa prej tyre janë varfëria, mungesa e strehimit, vështirësi në arsimim, shërbimi jo i mirë shëndetësor, kriminaliteti në shkallë të lartë etj. Të gjitha këto nxjerrin si domosdoshmëri zbatimin e politikave të duhura për zbutjen e efekteve të lëvizjeve të brendshme.

Fjalë kyçe: migrimi i brendshëm, urbanizim, probleme sociale, politika sociale

SUMMARY

The rapid urbanization as a result of internal population is considered as one of the main features of the Albanian society after 1990. The urbanization's trend is associated more with the depopulation of rural and mountainous areas, rather than natural growth. People were settled in areas designated as land for agriculture and industry development, banks of the rivers, lake or protected areas. Internal movement of population has not moved parallel to the local government intervention. Rapid urbanization is important for the growth of national economy, but on the other hand, when it occurs in a chaotic way, it is accompanied by social problems. Shkodra continues to have higher poverty rate, high rates of unemployment, lack of housing directly, not good welfare services, high level of criminality etc. In order to improve this social panorama and to mitigate the effects of internal movements, it is important to implement the appropriate policies.

Key words: internal migration, urbanization, informal areas, social problems, social policy

Hyrje

Gjatë 20 viteve të fundit qyteti i Shkodrës ka pësuar një sërë ndryshimesh komplekse dhe të menjëhershme në të gjitha aspektet, ekonomike, shoqërore dhe politike. Shprehje e qartë e dukurive të paparashikuara dhe të reja për shoqërinë shqiptare ishte ndryshimi i menjëhershëm i peisazhit fizik dhe human.

Ndërveprimi i shumë aktorëve, në mes të të cilëve ndryshimi i strukturës ekonomike dhe shpallja e lirisë së qytetarëve për të lëvizur, i dha udhë procesit të urbanizimit të shpejtë si një ndër proceset kryesore të shoqërisë shqiptare të pas viteve 1990. Qyteti i Shkodrës u përball me rritje të menjëhershme të popullsisë dhe zgjerim të sipërfaqes nga njëra anë dhe mungesë

eksperience në menaxhim të situatës së re të krijuar, nga ana tjetër, gjë që kushtëzoi lindjen e problemeve ekonomike dhe sociale. Përbalja me këto probleme gjatë punës së mëparshme kërkimore që kishte për qëllim studimin e lëvizjeve në hapësirë, krijoi premisat për studim të mëtejshëm të tyre (Akhemi, Fischer, Gjoni, Kopliku, 2008). Objektivi i këtij studimi nuk është vetëm thjesht përshkrimi dhe radhitja, por edhe përpjekja për të dhënë sygjerime për përdorimin e politikave sociale sa më efektive. Ky studim **paraqet interes**, sepse përqendrohet tek rajoni i Shkodrës dhe tiparet e lëvizjes së popullsisë brenda tij.

Materialet dhe metodat

Si pasojë e mungesës së të dhënave është e vështirë të përcaktohet madhësia dhe vëllimi i këtyre flukseve, që kanë patur intensitet të ndryshëm në periudha të ndryshme. Është e vështirë të përcaktohet me shifra të sakta numri i të ardhurve dhe të shpërngulurve për shkak të mosdeklarimeve për ndryshim banese dhe për shkak të mungesës së regjistrimit të këtyre flukseve. Akoma edhe më i vështirë është menaxhimi i problemeve sociale që rezultojnë nga lëvizjet kaotike. Por ndryshimi i peisazhit, qoftë fizik apo human, të qytetit të Shkodrës është i dukshëm. Megjithatë, jemi bazuar në të dhënat dytësore të marra nga Zyra e Gjendjes Civile pranë Bashkisë Shkodër, INSTAT si dhe në bisedat dhe pyetësorët e realizuar me banorët e vendosur në qytetin e Shkodrës pas 1990-ës. Meqënëse tema e përzgjedhur është interdisiplinare, është konsultuar edhe material nga literaturë shqiptare dhe e huaj që paraqet aspekte të zhvillimit të migrimit dhe problemeve sociale nga gjeografë, sociologë, ekonomistë etj. Janë përdorur kryesisht metodat cilësore, analitike dhe krahasuese.

Rezultate dhe diskutime

Lëvizja intensive e brendshme e popullsisë, nga fshati drejt qytetit ndryshoi shpejt dhe dukshëm raportin në mes popullsisë urbane dhe asaj rurale. Pavarësisht se Qarku i Shkodrës ka pësuar rënie të popullsisë tij në 10 vitet e fundit, vihet re

që është rritur pesha specifike e popullsisë urbane kundrejt popullsisë rurale. Në vitin 1990, 34,9% e popullsisë së Qarkut Shkodër ishte urbane, në vitin 2001 ajo përbënte 37,3% dhe në 2011 44,3% e popullsisë së përgjithshme të qarkut ishte popullsi urbane (INSTAT). Rritja e popullsisë urbane vjen si pasojë e rritjes natyrore si dhe “saldos migruese positive”. Pavarësisht se lindshmëria ka ardhur drejt rënies, si për shkak të planifikimit familjar dhe rritjes së nivelit arsimor, ajo vazhdon të ndikojë në rritjen e përgjithshme të popullsisë, duke patur parasysh edhe vlerat në rënie të vdekshmërisë. Edhe në zonat me të ardhura të ulta të qytetit, që kanë kushte të papërshtatshme banimi dhe shërbimi shëndetësor, vdekshmëria në përgjithësi është më e ulët se në zonat rurale.




Figura 1: Lëvizja e popullsisë në qytetin e Shkodrës (Burimi: Bashkia Shkodër)

Megjithatë lëvizja e brendshme e popullsisë është faktori më i rëndësishëm në procesin e urbanizimit. Për një dekadë, ajo është shfaqur në ardhjet e vazhdueshme të banorëve nga zonat rurale drejt qytetit të Shkodrës, me shpresën e një jete më të mirë. Pavarësisht se qyteti i Shkodrës gjatë gjithë kësaj periudhe është karakterizuar nga vlera të larta të papunësisë, 28% (UNICEF), ky faktor nuk e ka zbrapsur fluksin e ardhjeve nga zonat rurale. Sipas ekonomistit Michael Todaro (1969) mund të identifikohet “e arsyeshmja” edhe tek migrimi drejt papunësisë. Sipas tij, kur diferenca e të

ardhurave në mes zonave urbane dhe rurale është shumë e gjerë (gjë e dallueshme për qarkun e Shkodrës), atëherë migrimi përbën një zgjidhje të arsyeshme. Edhe pse mundësia e banorëve të rinj për të gjetur punë ishte e ulët, kur kjo punë gjendej, ajo kishte të ardhura shumë më të larta krahasimisht me vendbanimin. Lidhjet e gjakut apo të miqësisë kanë shërbyer në ndihmën ekonomike dhe sociale që shpesh ata i kanë dhënë njëri-tjetrit. Por, edhe shërbimet më të mira shëndetësore, arsimore, kushtet më të përshtatshme të infrastrukturës dhe jeta më e pasur kulturore ishin faktorë të fortë tërheqës që ndikonin në vendimin e njerëzve për të lëvizur dhe braktisur vendin e origjinës. Por, analiza e treguesve të numrit të popullsisë së qytetit të Shkodrës gjatë viteve, tregon që ky fluks ka pësuar rënie. Deri në fillimet e vitit 2000 popullsia e qytetit të Shkodrës është rritur në mënyrë të vazhdueshme, por pas vitit 2003 “saldoja migruese negative” dhe rënia e numrit të lindjeve kanë ndikuar në rënie të numrit të përgjithshëm të popullsisë së qytetit të Shkodrës. Kjo shpjegohet me pakësimin e këtyre të fundit pas braktisjes së zonave të tëra rurale që, nga ana tjetër, filluan gradualisht të përballen me problemin e desertifikimit të tokave të punueshme.




Figura 2: Të vendosurit dhe të shpërngulurit në qytetin e Shkodrës në vitet 1991-2010 (Burimi: Zyrat e Gjendjes Civile)

Urbanizimi i shpejtë ka qenë i rëndësishëm për rritjen e ekonomisë kombëtare. Në qytet gjendet një numër i madh punësh të sektorit modern në ndërmarrje të vogla dhe të mesme, ashtu sikurse edhe në administratë dhe në shërbime publike. Sistemi ekonomik i tregtisë së lirë dha mundësinë e hapjes së shumë bizneseve të vogla dhe disa bizneseve të mëdha, që rritën edhe mundësitë e punësimit. Popullsia e ardhur ishte kryesisht në moshë të re dhe përbënte një forcë të mirë aktive për qytetin. Përveç kësaj, rritja e numrit të shërbimeve, si dhe rritja e nevojave për ndërtim, hapën të tjera fronte pune dhe rritën mundësitë e punësimit. Qyteti u zgjerua dhe shumë shpejt ndryshoi edhe hapësira sociogjeografike e tij. Peisazhi human u pasurua me elementë që nuk ekzistonin më parë dhe që lidheshin kryesisht me përmirësimin e vendeve sociale të banimit dhe prurjen e shumë risive në sektorin e ndërtimit. Por nga ana tjetër pati edhe ndryshime të të gjitha vendeve të tjera sociale. U rritën në mënyrë të konsiderueshme vendet sociale të argëtimit dhe të shkëmbimit në trajtën e ndryshimeve që pësoi në përgjithësi sektori terciar i ekonomisë. Disa firma të huaja filluan të ushtrojnë aktivitetin e tyre në qytet, sepse krahu i punës që ofrohej kishte kosto më të ulët. Shumë prej të ardhurve, kryesisht grupmoshat e reja të gjinisë femërore, u punësuan në sektorë të industrisë së lehtë si në përpunimin e ushqimit, prodhimet e veshjeve dhe të këpucëve apo në shërbime. Numri i këtyre subjekteve ekonomike arriti kulmin në vitet 1994-1995 si rrjedhojë e reformave ekonomike, por pësoi një rënie drastike në vitet 1997-1999. Si pasojë e trazirave të 1997 shumë investitorë vendas dhe të huaj u larguan nga mungesa e sigurisë publike dhe rendit kushtetues. Kushtet e vështira ekonomike, varfëria, mungesa e shërbimeve sociale, sidomos atij shëndetësor apo mungesa e infrastrukturës kanë ekzistuar edhe para nisjes së valëve imigruese në qytet. Por, rritja e menjëhershme e popullsisë, i bëri akoma më të vështira përpjekjet për të luftuar situatën e disfavorshme social-ekonomike. Ndërkohë që nxitja e emigrimit nga zonat rurale është parë si një zgjidhje potenciale e problemit të varfërisë në Shqipëri, migrimi ka

kontribuar gjithashtu në çrregullime sociale dhe në përkeqësimin e shpejtë të sigurimit të shërbimeve sociale në zonat urbane (shih *Calogero Carletto, Benjamin Davis, Marco Stampini, Stefano Trento and Alberto Zezza - Internal Mobility and International Migration in Albania*).

Rritja e shpejtë e popullsisë përfaqësonte një rritje të presionit mbi mundësitë e pakta të punësimit që ofronte qyteti. Para 1990 ishin zonat rurale që mbanin përqindjen më të lartë të krahut të punës me qëllim punësimin në kooperativa, por rënia e ekonomisë bujqësore solli edhe rritjen e numrit të të papunëve në këto zona. Ata u drejtuan drejt qytetit i cili ishte qendër e shërbimeve dhe e punësimit industrial. Shpërndarja e pabarabartë e kërkesës dhe ofertës për krahun e punës, rënia e aktivitetit bujqësor, shkatërrimi ose reduktimi i aktiviteteve industriale që operonin në qytetin e Shkodrës ndikoi në rritjen e vlerave të papunësisë.

Pavarësisht se sot në shkallë rajonale qyteti i Shkodrës ka vlera më të ulta të papunësisë krahasimisht me zonat rurale, Rajoni i Shkodrës vazhdon të ketë shkallë më të lartë të papunësisë krahasimisht me mesataren (13,5%).




Figura 3: Të dhëna për punëkërkuesit e papunë të regjistruar në ZP për vitin 2010-2011 (Burimi: Shërbimi kombëtar i punësimit)

Edhe pse varfëria është një fenomen kryesisht rural në shumë vende në zhvillim dhe me ekonomi në tranzicion, migrimi i brendshëm po krijon një rritje të varfërisë urbane duke sjellë pasoja sociale dhe ekonomike edhe pozitive, edhe negative. Shtresëzimi social dhe rritja e pabarazisë në mes shtresave të ndryshme të popullsisë dallohet dukshëm në shoqërinë qytetare sidomos në dallimet midis të ardhurave, banesave apo shërbimeve të tjera sociale. Mbi 12,4% e familjeve të qytetit përfiton ndihmë ekonomike e cila nuk mjafton as për përmbushjen e nevojave kryesore të jetesës. Por, kjo shifër duhet të jetë akoma më e lartë, duke patur parasysh se shumë familje të ardhura nuk janë regjistruar pranë gjendjes civile dhe nuk kanë bërë shkëputjen përfundimtare nga vendbanimi i tyre i mëparshëm. Kjo kategori nuk përfiton ndihmë ekonomike.




Figura 4: Punësimi dhe papunësia në vitet 2004-2010 (Burimi: Bashkia Shkodër)

Problemet sociale duhen parë në një kontekst akoma dhe më të gjerë.

Sipas një vlerësimi të situatës social-ekonomike në Shqipëri nga UNICEF: “ *Grupet e rrezikuara përfaqësohen gjithashtu dhe me kategori të cilat janë të përjashtuara nga e drejta themelore për të patur një banesë, një ushqim të mjaftueshëm, ngrohje dhe veshje në dimër, punë në përputhje me aftësitë fizike dhe nivelin arsimor, shkollë afër*

shtëpisë dhe mundësi për ta ndjekur atë, shërbim primar shëndetësor, mbrotje nga grabitja dhe dhuna, të drejtë dhe zë për të kërkuar të drejtat”.

Meqënëse rritja e popullsisë urbane ka qenë e shpejtë dhe, shpesh i ka kaluar ritmet e investimeve qeveritare dhe private, është lënë pas dore mundësia e infrastrukturës fizike dhe, sidomos e banimit, gjë që ka rezultuar me problem të mbigrumbullimit në disa zona dhe krijimin e vendbanimeve krejt të reja pa një plan paraprak. Këto zona të reja banimi janë krijuar duke zënë tokat e të tjerë pronarëve, duke ndryshuar destinacionin e përdorimit të tokës nga hapësirë për shfrytëzim industrial në vende rezidenciale, duke u vendosur në toka bujqësore, apo duke ndërhyrë pa kriter në mjedis sidomos në rastet e pushtimit të brigjeve të liqenit ose të lumenjve. Duke u integruar në jetën ekonomike dhe sociale të qytetit, të vendosurit e rinj kanë përmirësuar gradualisht edhe vendbanimet e tyre. Madje, karakteristikë e zonave informale është cilësia e mirë dhe standarti i lartë i banesave. Prandaj problemi i strehimit prek gjithë popullsinë e qytetit, dhe nuk është i kufizuar tek grupet e të ardhurve rishtaz. Është e vështirë të përcaktohet numri i familjeve pa shtëpi; pavarësisht se në Shkodër rezultojnë të regjistruara 1562 të tilla, supozohet që numri i vërtetë është rreth 3900. Edhe asimilimi i banorëve të ardhur me popullsinë vendase dhe integrimi i tyre në jetën e qytetit ka qenë i shpejtë dhe nuk kanë patur probleme të segregimit, sikurse ndodh në metropolet botërore. Kjo i detyrohet gjuhës, besimit fetar dhe kombësisë së përbashkët, si dhe ngjashmërisë në traditat dhe tiparet kulturore. Problematike për këto zona është mungesa e veprimit të ligjit, janë të pasigurta dhe kanë shpesh edhe konflikte.

Sot gjithnjë e më tepër vëmendja e qeverive në mbarë botën po përqendrohet në implementimin e politikave të përshtatshme për kontrollin e lëvizjeve të brendshme nga zonat rurale drejt zonave urbane. Numri i tyre është rritur nga 47%

në 1976 në 65% në 2007. (shih Cecilia Tacoli “environment and urbanization, Governance, migration and local development”).

Meqënëse mirëqenia sociale është e lidhur me mirëqënien ekonomike, duhen gjetur strategjitë e përshtatshme dhe të qëndrueshme për përmirësimin e cilësisë së jetës dhe zhvillimin e qëndrueshëm të qytetit. Nxjerrja e familjeve shkodrane nga varfëria, do të ndikonte dukshëm edhe në përmirësimin e situatës sociale. Për këtë nevojitet hapja e vendeve të punës, sidomos duke përmirësuar klimën e investimeve nëpërmjet shfrytëzimit të pikave të forta të qytetit.

Urbanizimi dhe rritja e shpejtë e popullsisë kanë ndryshuar edhe mënyrën e jetesës së banorëve të qytetit. Rregullimi i infrastructures, duke lehtësuar edhe aksesin e banorëve të zonave informale në shërbimet publike, do të ndihmonte akoma më tepër integrimin e tyre në jetën e përditshme. Përmirësimi i arsimit nëpërmjet përqendrimit të vëmendjes më tepër në arsimin profesional është një tjetër mundësi që mund t’i jepet sidomos grupmoshave të reja të cilat janë të riskuara më tepër për emigracion.

Bibliografia

- UN_HABITAT; 2010: Informal urban development in Europe: experiences from Albania and Greece, Technical Chamber of Greece, Athens
- W.T.S Gould (2009) “Population and Development”,
- UNICEF, 2000, Vleresimi I situates social ekonomike ne rajonet e Shqiperise,
- Calogero Carletto, Benjamin Davis, Marco Stampini, Stefano Trento and Alberto Zezza - Internal Mobility and International Migration in Albania*
- Raporti I Planit strukturor te qytetit Shkoder (2011)
- World population policies (2009).